



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 26
Prishtinë, më 17 Tetor 2012, në orën 09:00 sala N-302
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Bali Muharremaj, Adem Grabovci, Valbona Dibra dhe Albert Kinolli, Mursel Haljilji dhe Afrim Hoti.

Munguan: ishin të pranishëm të gjithë.

Të ftuar: z. Ramë Buja, Ministër, MASHT dhe Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm,

Stafi Mbështetës i Komisionit: Mehmet Simnica - Zyrtar i fushës për ekonomi.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011;**
3. **Të Ndryshme.**

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2011

Kryetari – Në vitin e kaluar, MASHT kishte 6 rekomandime të dhëna nga ZAP-i dhe vetëm një nga këto është adresuar. Shpenzimi i buxhetit ishte në nivel të kënaqshëm, vetëm, se shpenzimi me i madh është bërë në tremujorin e fundin të vitit edhe atë në investime kapitale. Pagesa e punëtorëve për punë jashtë orarit në kohën kur ata ishin në pushim vjetor, punëtor me dy kontrata të rregullta të punës, të punësuar që kanë lartësi të ndryshme të pagave dhe që nuk përputhen me kontrata të punës.

Në fushën e prokurimit auditori ka audituar 85 mostra dhe nga kjo ka vërejtur këto parregullsia: lidhja e kontratave pa zotim të mjeteve si për shkollën fillore në Prishtinë, Fasadimi i Konviktit numër 3, Renovimi i Fakultetit Ekonomik, po ashtu MASHT nga viti 2009 ka kontraktuar 23 shkolla që ende nuk janë përfunduar, dhënie e kontratave me çmim më të shtrenjtë, nuk është përdorë kriteri çmimi më i ulët - me arsyetim se afati i kryerjes së punëve është me i shkurtër, tejkalimi i limiteve për telefonat fikse në shumën prej 23,000 euro.

Sipas auditorit në zyrën për certifikimin e pagesave janë vërejtur parregullsia në dosjen sa i përket „Blerjes së Librave nga klasa 1 deri në klasën 9” nga shuma prej 500,000 euro, ndërsa projekti ka kushtuar 7.5 milionë euro, kjo nënkuptohet se është bërë kontratë pa fonde në dispozicion, po ashtu nuk ka dëshmi mbi pranim dorëzimit të materialit.

Problem në vete paraqitet edhe borxhet e papaguara nga viti në vit kjo në veçanti tek Universiteti i Prizrenit.

Ramiz Lladrovci – Opinioni i MASHT-it nga ZAP është i pakualifikuar në theksim të çështjes. Kjo në fakt tregon se MASHT është në rrugë të mirë në Menaxhimin e Financave Publike, përkundër disa dobësive të dhëna edhe në raportin e Auditorit për vitin 2011, si lidhja e kontratave pa zotim të mjeteve, punëtorë me dy kontrata të rregullta pune, regjistrimet në kodet ekonomike të gabuara, shpenzimet me të larta se sa limiti në shpenzimet të telefonisë fikse. Janë disa nga shkeljet që janë konstatuar në raportin e Auditorit.

Armend Zemaj – Në fakt pasqyrimi i raportit të ZAP për MASHT-in nëse krahasohet me vitin paraprak ka avancime, megjithatë duhet të kemi kujdes në aspektin e investimeve kapitale edhe pse dhënia e kontratave pa zotim të mjeteve nuk është e lejuar.

Trajtim të veçantë mendoj kërkon dhënia e kontratave për shërbime të veçanta, ku në disa Organizata Buxhetore është bërë dukuri. Kjo nuk është e lejuare me Ligj dhe si e tillë duhet të ndalohet. Po ashtu pagesa jashtë orarit të rregullt të punës, e veçanërisht kur ata janë në pushim vjetor. Eliminimi i këtyre të metave do të jete në interes edhe për vete institucionin dhe mendoj se marrja e masave duhet të jetë nga menaxhmenti i vet Organizatës Buxhetore.

Mursel Haljilji – U interesua nëse MASHT ka ndonjë projekt për shfrytëzimin e Energjisë Solare nëpër shkolla, si dhe a ka marrë masa konkrete MASHT për adresimin e të gjeturave të ZAP-it për vitin 2011, sipas planit të veprimit që kanë dorëzuar në ZAP në fillim të vitit 2012.

Valbona Dibra – Të gjeturat e ZAP-it për MASHT-in janë të natyrës jo materiale. Përgëzoi ministrin dhe stafin e MASHT-it për të arriturat në punë duke i këshilluar që rekomandimet e pa përmbushura të Auditorit t’i zbatojë deri në fund.

Ramë Buja- MASHT- Lidhur me pyetjen e Deputetit Mursel – tha se me përgjegjësi të plotë ka ndërmarrë masa konkrete si në telefonin fikse, po ashtu edhe të lidhjes së kontratave pa zotim të mjeteve, edhe pse ndërtimi i shkollave është specifikë që vazhdon me nga 2-3 vjet. Mirëpo, brenda vitit 2012 do të bëhet finalizimi i pjesës dërmuese të këtyre kontratave. Po ashtu janë marrë konkretisht me çështjen e kontratave mbi vepër dhe gjatë vitin 2012 nuk kanë lejuar të përsëritet një gjë e tillë.

Xhavit Dakaj – MASHT- Çështja e kontratave mbi vepër është bërë me ata persona që kanë pasur kontratë mbi vepër me MASHT-in si anëtar të një komiteti, komisioni, një bordi dhe që pajtohem plotësisht se këto kontrata kanë qenë në kundërshtim me nenin 80 të LMFPP. Mirëpo

me ardhjen time si sekretar i Ministrisë këto gjëra janë ndërprerë. Po ashtu dallimet në nivel pagash nuk janë brenda administratës së MASHT-it, por janë në programe të tjera të MASHT-it, si: në Qendrën e Studentëve, si dhe në Bibliotekën Kombëtare dhe se këto janë raste shumë të rralla dhe se tani me Ligj të ri mbi paga kjo do të tejkalohet.

Xhemajl Buzu- MASHT- Sa i përket projektit të Blerjes së Librave nga klasa 1-9, nuk kemi borxh këto mjete janë paguar pothuajse gjithherë me vonë dhe kjo për shkak të mungesës së fondeve, po ashtu MASHT gjithherë ka negociuar me kompanitë botuese për çmimin e teksteve shkollore dhe nëse krahasohet nga viti në vit kemi rënie të çmimeve për njësi. Ajo që është konstatuar nga Auditori se nuk ka regjistër për pranim dorëzimit të Librave nuk qëndron ngase janë dorëzuar Librat në shkollë në baze të një regjistri paraprak. Po ashtu sa i përket kontratave pa zotim të mjeteve, është bërë zotimi i mjeteve për atë sa kanë qenë fondet në dispozicion. Mirëpo, ne nuk është bërë lidhje e kontratave pa sigurimin e ekzekutimit të projektit.

Artan Venhari- ZAP- Të gjeturat janë në vitin 2011 ngase auditimi është bërë në buxhetin e vitit 2011, dhe sipas të gjeturave është vërejtur se në zyrën për certifikim të pagesave nuk ka ekzistuar dosja komplete për projektin „Blerja e Librave nga klasa 1-9“, si dhe për disa projekte të tjera të cekura në raport.

Zukë Zuka- ZAP- Në kohën e Auditimit të zyrës së certifikimit të pagesave në MASHT-ë kemi vërejtur se në projektin „Blerja e Librave“ ka munguar dëshmia e pranimit dhe dorëzimit të Librave, dhe kjo është thënë në raportin e Auditimit të ZAP-it.

Ramiz Lladrovci – Tha se do të ishte mirë që nëse tani dosja është kompletuar, një informacion për këtë t’i dorëzohet Komisionit për informacion shtesë.

Haki Sfishta-MASHT- Dosja nuk ishte e kompletuar në momentin e auditimit, mirëpo fletëdëshmit për këtë kanë ekzistuar në zyrën e prokurimit të MASHT-it.

Armend Zemaj – U pajtua se dosja ka mundur të jetë diku në zyra të tjera, por nuk pajtohet me atë se si ka mundur të bëhet pagesa kur zyra për certifikim të lëndëve në MASHT nuk e ka pasur lëndën komplet për projektin e lartcekur dhe këtu lind dyshimi për keqpërdorim në çështjen e pagesës për këtë projekt.

Kryesuesi Konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e financave Publike, njëzëri nxori këtë

Përfundim

MASHT, në afat prej dy muajve, të ofrojë dëshmi konkrete për Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike, lidhur me adresimin e të gjitha rekomandimeve të ZAP-it për vitin 2011, e në veçanti dëshmitë konkrete për projektin „Blerja e Librave nga klasa 1-9“.

3. Diskutim rreth takimit të punës, me mediat të organizuar nga KIPRED më 22 dhe 23 Tetor 2012

Kryetari - Njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur takimin e punës me mediat të organizuar nga KIPRED më 22-23 tetor 2012 në Bogë. Sipas tij ky takim do të mbahet të hënën më 22 dhe të martën më 23 tetor.

Kryetari Konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Përfundim

- 1. Takimi me përfaqësues të mediave do të mbahet më 22 dhe 23 tetor 2012 në Bogë.**
- 2. Shpenzimet për këto dy aktivitetet të Komisionit mbulohen nga KIPRED.**
- 3. Transporti sigurohet nga Kuvendi i Kosovës.**

Mbledhja përfundoi në orën 10:00.

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu